Kosovo Solutions
Sheshi Nënë Tereza
10000, Prishtinë
Republika e Kosovës

01 mars 2019, Prishtinë

**Letër Motivimi**

I/E nderuar,

Duke iu referuar vendit të lirë të punës të shpallur në Portalin Kastori, përmes kësaj letre shpreh interesin të aplikoj në pozitën e Menaxherit të Programit në kompaninë Kosovo Solutions. Unë jam një profesionist i arsimuar në Menaxhim Biznesi dhe me një përvojë të gjerë të udhëheqjes së programeve në fusha të ndryshme.

Gjatë funksionit tim të mëparshme si Menaxher i Programit në XXX, unë kam qenë përgjegjës për monitorimin e projekteve, hartimin e planeve të punës, dhe përcaktimin e objektivave të projektit. Unë gjithashtu kam kordinuar Menaxherët e Projekteve përderisa kam zhvilluar afatet kohore dhe planet e kërkuara buxhetore. Unë kam njohuri të thella të metodave të menaxhimit të projektit dhe kam shkathtësi të mira të punës me Microsoft Office dhe në softuerin për menaxhimin e projekteve.

Unë jam i diplomuar në programin e Menaxhimit të Biznesit në Universitetin e Prishtinës. Gjatë kësaj kohe, unë kam studiuar për financa, logjistikë, menaxhimin e burimeve njerëzore, marketing, kontabiliteti dhe kontrollin e cilësisë. Unë besoj se edukimi im më jep një bazë solide në karrierën time si Menaxher i Programit

Ju lutem gjeni të bashkëngjitur kopjen e CV-së time. Unë do të jem e disponushme dhe do ta vlerësoja shumë mundësinë për t'u takuar me ju për të diskutuar më tej përshkrimin e detyrave të punës.

Ju mund të më kontaktoni në telefon xxx ose me e-mail në xxx

Duke ju falenderuar paraprakisht për vëmendjen që i kushtuat kësaj letre, ju lutem pranoni përshendetjet më të sinqerta nga ana ime.

Sinqerisht,
[Emri mbiemri juaj]